Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+, në Universitetin Politeknik të Barit, Itali

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës në Universitetin Politeknik të Barit, Politecnico di Bari, Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe të kenë përfunduar një vit akademik.

Kohëzagjatja e bursave: 5 muaj, 1 semestër – semestri i II, viti akademik 2026-2027

Fusha e studimit: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Numri total i mobiliteteve: 5 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

Përparësi në nominimin e studentëve kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazhuara. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)

*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze dhe/ose në gjuhën italiane, ku niveli minimal i kërkuar është:

- Bachelor: Italian B1 and/or English B2;
- Master: English B2

Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ''Mobility Plan''. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Politeknik të Barit lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.
Dokumenti ''Learning Agreement'' tek seksioni ''Commitment'' firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik iFakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për formatin e "Learning Agreement", ju lutemi, shihni formatin bashkëlidhur.

Didattica | Dipartimento Architettura Costruzione e Design (ArCoD) | Politecnico di Bari

Afati për aplikim për studentët: Deri më 15 dhjetor 2026, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al